



FTESË PËR SESIONIN INFORMUES

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin **“Trajnimi profesional dhe mundësitë për gjenerimin e të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Kosovës”**, periudha e zbatimit të projektit korrik 2019 dhjetor 2020 i përkrahur nga Donatori CFD nga Zvicra. Projekti do të përfshijë komunat: Lipjan, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë, dhe Zubin Potok.

Projekti do të kontriboj që gratë fermere dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të trajtohen në mënyrë të barabartë në aspektin e mundësive për punësim, krijimin e të ardhurave dhe në mënyrë më specifike në drejtim të përdorimit të të drejtave të tyre.

Projekti përfshin trajnime profesionale në kultivimin e perimeve, përgatitjen e ëmbëlsirave dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve, vizita për shkëmbim përvojash mbrenda Kosovës, përkrahje me serra dhe krijimi i njësive për përgatitjen e ëmbëlsirave dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve, tryezë të rrumbullakët, trajnime për studentet dhe angazhimi në punë praktike si dhe trajnime në vendimmarrje, avokim dhe lobim.

Për informata më të hollësishme në lidhje me aktivitetet e projektit dhe mundësitë e aplikimit, ftohen të gjitha kandidatet e interesuara që të marrin pjesë në sesionin informues që do të mbahet në:

Vendi: Salla e kuvendit në Komunën e Shtimes

Data: 18 Korrik 2019

Ora: 10:00.

Singerisht,
Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv i IADK-së





Agjenda

Sesion informues

Projekti Trajnimi profesional dhe mundësitë për gjenerimin e të ardhurave në bujqësi për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zonat rurale të Kosovës “

- 10:00 - 10:15 Regjistrimi i pjesëmarrësve
- 10:15 – 10:25 Fjala e mirëseardhjes – DE Zenel Bunjaku IADK
- 10:25 - 10:30 Fjala e rastit –Kryetari i Komunes/përfaqesuese i
Komunës Shtime
- 10:30 - 10:50 Prezantimi i projektit – Hafize Veseli, IADK
- 10:50 - 11:00 Prezantimi i aplikacionit
- 11:00 - 11:15 Diskutime, pyetje dhe përgjegjeje për të pranishmit